

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Diplomacia e dollarit" vjen në Shqipëri/ The New Yorker: Si u hapën dyert për Kushnerin
ADRESA	https://lapsi.al/diplomacia-e-dollarit-vjen-ne-shqiperi-the-new-yorker-si-u-hapen-dyert-per-kushnerin-i1093759
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:41:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:37:23 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fab328731c9e7c1b6c15412c89be14ebdeb853f06873be31572686e61ca9244
TEKSTI	4a86c10b0fb45c3f787104ed007fb003826febe8a400cb1ce3b46409273ca960
PAMJA	6e73268a17c55b4cd44fc9f7d3d636243474e03060bea676f4a42d379dd2952b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2bc4b6bc8e871a4f5cb82897c283b773547681e633024aea869eab9169e713de
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2bc4b6bc8e871a4f5cb82897c283b773547681e633024aea869eab9169e713de>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

"Diplomacia e dollarit" vjen në Shqipëri/ The New Yorker: Si u hapën dyert për Kushnerin

LAPS1.AL • 15 SEPTEMBER 2026



Shqipëria zë një pjesë të rëndësishme në një investigim të gjatë të revistës prestigjioze amerikane The New Yorker për Jared Kushnerin, dhëndrin e Presidentit Trump.

Në shkrimin e publikuar më 14 shtator, gazetari Dexter Filkins ndalet gjatë te marrëdhëniet e Kushnerit me Edi Ramën, projektet në Sazan dhe Zvërnec, statusi i investitorit strategjik, ndryshimet ligjore për zonat e mbrojtura, protestat dhe problemet e pronësisë mbi tokën ku parashikohet investimi.

Por për të kuptuar se përse Shqipëria futet në këtë investigim, duhet kuptuar më parë teza e tij.

Shkrimi titullohet *"Diplomacia e dollarit e Jared Kushnerit"*, ndërsa nëntitulli është edhe më i drejtpërdrejtë: *dhëndri i Trumpit përfaqëson, sipas revistës, "atë lloj figure të Uashingtonit për të cilën posti publik shërben si mjet drejt një pasurie të jashtëzakonshme"*.

Filkins e ndërton profilin e Kushnerit mbi një ide të vetme, përzjerjen gjithnjë e më të madhe mes diplomacisë dhe biznesit, mes funksionit publik dhe interesit privat.

Kushner paraqitet si një njeri që edhe konfliktet ndërkombëtare i trajton me logjikën e marrëveshjeve të pasurive të paluajtshme, *"dëgjon palët, negocion, ushtron presion dhe kërkon "deal"-in."*

Para se të arrijmë tek Shqipëria, shohim dy-tre shembuj shumë domethënës që jep autori jep mbi Kushnerin, se si ai përfiton në zgjidhjen e konflikteve ku ka mbretë, despotë dhe autokratë.

Në negociatat me Iranin, The New Yorker shkruan se Kushner dhe Steve Witkoff hynë

ide



Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsia

MOTITIRANA

28°C

KËMBIMIEURO

91.69

aktuale

28:58

Dhuna policore/ Protestuesit paralajmërojnë përshkallëzim: Do bllokojmë institucionet

08:10



Shtatori ndez protestat/ Qytetarët rikthehen në shesh, 107 ditë mobilizim kundër qeverisë



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



ne disedime pa eksperituzen teknike te nevojshme per nje cesnje aq komplekse sa programi berthamor iraniann.

Një ish-zyrtar amerikan i cituar në artikull thotë:

"Iranianët vijnë tek ti me një propozim. Çfarë do të thotë realisht ai? Sa shumë i kthen pas, dy muaj apo dy vjet? Cilat janë mënyrat për ta anashkuar? Të mos kesh këshilltarë teknikë atje është thjesht neglizhencë totale profesionale."

Kjo mungesë ekspertize që pjesërisht dështoi negociatat, sipas autorit, u shoqërua të nesërmen me nisjen e bombardimeve të SHBA dhe Izraelit ndaj Iranit, ku u vra dhe lideri Ayatollah Khomeini.

I njëjti mentalitet, sipas shkrimit, u shfaq edhe në Ukrainë, ku një ish-zyrtar amerikan thotë për Kushnerin dhe Witkoffin:

"Ata mendojnë se kjo është një marrëveshje pasurish të paluajtshme. Nuk duket se e kuptojnë se kjo është një luftë."

Kkëtu Filkins kalon nga mungesa e eksperiencës te konflikti i mundshëm i interesit.

Ndërsa Kushner negocion në emër të Shteteve të Bashkuara me vende të Lindjes së Mesme, fondi i tij privat, Affinity Partners, menaxhon miliarda dollarë të investuar pikërisht nga qeveritë e atij rajoni. Rasti më domethënës është Arabia Saudite.

Gjatë mandatit të parë të Trumpit, Kushner ndërtoi një marrëdhënie të afërt me liderin defakto Mohammed bin Salmanin dhe e mbrojti politikisht edhe gjatë krizës që pasoi vrasjen e gazetarit Jamal Khashoggi.

Gjashtë muaj pasi Trump u largua nga Shtëpia e Bardhë, Kushner kërkoi 2 miliardë dollarë nga fondi sovran saudit për Affinity Partners.

Sipas dokumenteve të cituara nga The New Yorker, profesionistët e fondit kishin kundërshtime serioze. Firma nuk kishte histori të matshme investimesh, Arabia Saudite merrte pjesën kryesore të rrezikut dhe tarifat konsideroheshin të larta. Por kryetar i fondit ishte Mohammed bin Salman.

Komiteti u anashkalua dhe investimi prej 2 miliardë dollarësh u miratua. Vetëm tarifa e administrimit prej 1.25 për qind nënkuptonte më shumë se 25 milionë dollarë të ardhura në vit për fondin e Kushnerit, pavarësisht performancës. Më pas erdhën edhe 200 milionë dollarë nga Emiratet dhe 200 milionë të tjera nga Katari.

The New Yorker nuk pretendon se ekziston një provë direkte se këto para ishin shpërbllim për vendimet politike të Kushnerit. Por ndërton një tablo ku lidhjet e krijuara përmes pushtetit publik shndërrohen më pas në marrëdhënie private jashtëzakonisht fitimprurëse.

Dhe pikërisht në këtë kontekst revista e fut Shqipërinë.

Nga superjahti në Sazan


Historia shqiptare nuk nis në një tender apo në një zyrë shteti. Nis në një superjaht.

"Në verën e vitit 2021, Edi Rama, Kryeministri i Shqipërisë, u ftua në një superjaht të ankoruar pranë qytetit antik të Durrësit, në bregdetin e Adriatikut. Jahti, Planet Nine, ishte në pronësi të financierit Nat Rothschild, pasardhës i familjes europiane të bankierëve. Mes të ftuarve të tjerë ishin Kushner dhe Ivanka Trump."

Rama ishte në vitin e tij të tetë si udhëheqës i Shqipërisë dhe Kushner e trajtoi me respekt. "Kur e sheh në televizor, Jared duket si një vrasës shumë gjakftohtë dhe Ivanka duket si një person shumë i distancuar, i përqendruar te vetja", tha Rama. Nga afër, "nuk do ta besojë se të përlulur janë".



Rama lëshon Ballukun/ Top Channel nis sulmin: "Pse SPAK vonon kërkesën për arrestimin"



PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane



Del një tjetër PERGJIM i Ron Yeffet: Ministrinë e Energjetikës ma lini mua



Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën e tmerrshme në Pediatrinë e QSUT-së

Jahti e çoi grupin në Sazan, një ishull pothuajse i pabanuar në brigjet shqiptare. "Ndalëm për të notuar — në fakt kështu e zbuluam", tha Ivanka në podcastin "Founders". "Bëmë një ecje zbatuar deri në majë dhe thjesht u magjepsëm." - thuhet në artikullin që Lapsi.al e ka lexuar dhe e sjell në shqip.

Një ndalesë mes miliarderësh do të përfundonte pak vite më vonë në një projekt prej miliarda dollarësh.

"Sazani është një vend i ashpër, i mbushur me shkëmbinj dhe pemë të ngatërruara, i populluar nga një koloni e madhe minjsh dhe i mbushur me bunkerë të ndërtuar nga diktatori marksist Enver Hoxha për t'u mbrojtur nga një pushtim imagjinar. Por ofron pamje të gjera mbi një det ngjyrë bruz dhe Kushnerët panë një mundësi atje. Ata ishin inkurajuar më herët të investonin në Shqipëri nga Richard Grenell, i cili kishte shërbyer më parë si i dërguar special i Trumpit në rajon dhe më pas kishte punuar me Affinity.

Disa muaj më vonë, Kushner i tha Ramës se dëshironte të ndërtonte resorte në Sazan dhe në gadishullin e Zvërnecit, i cili mbron një lagunë të gjerë. Ai imagjinonte një qytezë për super të pasurit, me fusha golfi, port jahtesh dhe dhjetë mijë dhoma hotelesh dhe njësi apartamentesh. Projektet do të kërkonin një investim prej rreth katër miliardë dollarësh; për fazën e parë, Kushner siguroi financim nga dy miliarderë nga Katari." - shkruan Dexter Filkins.

Rama hap dyert

Nga këtu nuk kemi më thjesht një investitor që ka pëlqyer një ishull shqiptar. Fillon raporti me pushtetin.

"Ramës i pëlqeu shumë ideja e Kushnerit. Ai besonte se projekti do të krijonte mijëra vende pune dhe do ta kthente Shqipërinë, e cila është një nga vendet më të varfra në Europë, në një destinacion për llojin e njerëzve me të cilët ai shoqërohej në Davos. "Është fakt që turizmi i nivelit të lartë sjell më shumë të ardhura", tha ai. Rama e shpalli kompaninë e zhvillimit të Kushnerit "investitor strategjik", një status zyrtar që i mundësonte qeverisë të përdorte burime publike për të mbështetur projektin."

Autori ndalet më pas edhe te personazhi Rama dhe mënyra si shihet ai në Perëndim.

"Në qarqet elitare të Perëndimit, Rama është një lloj personazhi i njohur; ish-basketbollist, me trup të gjatë dhe një mjekër të gjatë gri që së bashku i japin pamjen e Moisiut me kostum sportiv. Është udhëheqës properëndimor i një vendi me shumicë myslimane dhe, siç i pëlqen t'u kujtojë njerëzve, një artist vizual i përkushtuar. Kur vizitova zyrën e tij në Tiranë, po bënte një vizatim abstrakt me lapsa me ngjyra.

Qëllimi i Ramës është ta çojë Shqipërinë, e cila ishte e izoluar nga Perëndimi për gati pesëdhjetë vjet gjatë epokës komuniste, në Bashkimin Europian. Ai më tha se plani i Kushnerit mund të ndihmonte. "Ai dëshiron të ketë një projekt simbolik që do ta identifikojë si dikë që kujdeset për të gjitha çështjet e ndjeshme të kohës, nga mjedisi te ruajtja, arti dhe kultura", tha Rama. "Ambicia e projektit është të bëjë diçka absolutisht unike, jo vetëm për Shqipërinë, por për Europën. Kjo është edhe ambicia ime." - shkruhet në artikullin e The New Yorker.

Paralajmërimi serb

Filkins ndërpret këtu historinë shqiptare për të treguar çfarë kishte ndodhur me një projekt pothuajse analog të Kushnerit në Serbi.

"Një projekt i ngjashëm i Kushnerit kishte përfunduar së fundmi në dështim. Në Serbi, fqinjë me Shqipërinë, ai dhe Grenell kishin planifikuar të ndërtonin një kompleks hotelerie dhe apartamentesh Trump International me vlerë pesëqind milionë dollarë. Projekti përqendrohej te ndërtesa e braktisur e Shtabit të Përgjithshëm, e cila ishte bombarduar nga avionët amerikanë në vitin 1999, gjatë një operacioni të NATO-s për të mbrojtur shqiptarët etnikë nga një fushatë terrori e sponsorizuar nga qeveria.

Ndërtesa ishte shpallur monument kulture i mbrojtur dhe Kushner kishte rënë dakord të respektonte shqetësimet e historianëve duke ndërtuar një memorial “kushtuar të gjitha viktimave të agresionit të NATO-s”. Qeveria e Presidentit Aleksandar Vučić, populist dhe mbështetës i zëshëm i Trumpit, përshpejtoi miratimet. Por nisën protesta dhe përfundimisht prokurorët serbë akuzuan ministrin e Kulturës për falsifikim dokumentesh për të siguruar lejet. (Ministri e mohoi këtë.) Nuk kishte asnjë tregues se dikush nga ekipi i Kushnerit kishte shkelur ligjin, por në prill ai vendosi të tërhiqej. “Projektet domethënëse duhet të bashkojnë dhe jo të ndajnë”, thuhej në një deklaratë të Affinity. ” - mbyll krahasimin autori Filkins.

Në Shqipëri, projekti nuk u tërhoq.

Ligji ndryshon dhe shfaqet projekti

Në këtë pikë revista vendos pranë njëra-tjetrës dy momente, ndryshimin e ligjit dhe shpalljen e projektit.

“Nëse projekti në Shqipëri i bashkoi njerëzit, megjithatë, i bashkoi kundër Kushnerëve. Në shkurt të vitit 2024, partia e Ramës, e cila kontrollonte shumicën në parlament, miratoi një amendament që mundësonte ndërtimin e projekteve luksoze në zona të mbrojtura, përfshirë Zvërnecin. Disa javë më vonë, Kushner shpalli planet e tij, dhe ëndrra e tij nisi të përplasej me realitetin politik të Shqipërisë.” - citon lapsi.al shkrimin.

Pastaj historia zbret nga ligji në territor.

“Megjithëse Ivanka e kishte quajtur Sazanin “ishull privat”, zona kishte qenë prej kohësh e hapur për publikun. Ndërsa zhvillimi në Zvërnec ishte planifikuar të ndërtohej në mes të një zone natyrore të mbrojtur prej dyzet mijë akrash. Partnerët lokalë të Kushnerit rrethuan me gardh një zonë që kishte qenë një vend popullor për plazhistët. Shqiptarët nisën të ankoreshin se atij i ishin dhënë të drejta zhvillimi pa njoftim publik apo garë konkurruese dhe se amendamenti për të hapur tokat e mbrojtura ishte kaluar me nxitim në parlament. Rama lejoi madje ndërtimin e një aeroporti brenda zonës së mbrojtur.”

Nga resorti te revolta politike

Sipas autorit Dexter Filkins, projekti shumë shpejt pushoi së qeni vetëm një debat për Sazanin apo Zvërnecin.

“Pothuajse brenda natës, Rama u bë objekt i një zemërimi të gjerë dhe Kushner u kthye në një figurë negative, një plutokrat që kërkonte të transformonte një pjesë të madhe të vendit në një kënd lojërash për të pasurit. Sekretet rreth projektit i irritoi njerëzit; megjithëse pothuajse një e katërta e tij zotërohet nga biznesmenë shqiptarë, emrat e tyre fshihen pas një korporate offshore. Në qershor, banorët shembën gardhin përreth plazhit. Më pas nisën demonstratat publike. Çdo mbrëmje, njerëzit mblidheshin në sheshin kryesor të Tiranës dhe marshonin drejt rezidencës së Ramës, një milje më tej, duke brohoritur gjatë rrugës.”

Më pas autori shpalos zhvillimin e protestës, nga Kushneri tek sistemi.

“Në fillim, protestuesit u përqendruan te ndalimi i projektit të Kushnerit. Por kur i vizitova, disa javë më vonë, objektivat e tyre dukeshin se kishin ndryshuar — tani synonin largimin e Ramës nga pushteti dhe rindërtimin e sistemit politik të Shqipërisë. “Kjo tani është shumë më e madhe se Jared Kushner”, më tha një natë Erlis Çela, profesor komunikimi në Tiranë, teksa marshonte me mijëra shqiptarë të tjerë. “Në këtë vend ka një grup shumë të vogël njerëzish me tepër para dhe, brenda natës, në errësirë, ata marrin të gjitha vendimet për vendin.”

Këtu projekti kthehet në simbol të mënyrës si perceptohet pushteti në Shqipëri.

Për shumë njerëz me të cilët fola, projekti i Kushnerit pasqyronte një të vërtetë shqetësuese për Shqipërinë: pasuria dhe pushteti i vendit mbaheshin nga një grusht

oligarkësh, të cilët ishin pasuruar përmes aktiviteteve të paligjshme, si pastrimi i parave për grupe kriminale ndërkombëtare. Të ardhurat nga paratë e pastruara, thoshin ata, shiheshin gjithandej në Tiranë, në formën e ndërtesave me apartamente kryesisht bosh që shqiptarët i quajnë “banka betoni”. “

Rama ka krijuar këtë sistem ku oligarkët, politikanët dhe mediat punojnë së bashku dhe kjo u jep licencë të bëjnë pothuajse çfarë të duan”, më tha Fatos Lubonja, gazetar i cili ishte burgosur si i dënuar politik gjatë komunizmit. “Ramës i duhen njerëz si Kushner për të qenë fytyra e tij, për t’i siguruar mbështetje ndërkombëtare.”” - zbulon gazetari Filkins.

Rama nuk tërhiqet

PDF GENERATED BY PDFELEMENT

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.